



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË  
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

Nr. 589/2 Prot.

Tiranë, më 02.07. 2024

**Lënda : Kthim Përgjigje**

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.589 Prot., datë 11.03.2024 “Kërkesë për miratim tipi” si dhe shkresës Nr. 589/1 Prot., datë 25.03.2024 “Dorëzim dokumentacioni”, Ju informojmë si më poshtë:

Referuar Ligjit nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”, Neni 18, **Vendosja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara**

1. Instrumentet matëse, që janë objekt i markimit CE, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim nëse kanë markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M dhe dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit të rrethuara nga një drejtkëndësh, lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE; numrin unik të trupës notifikuese që ka marrë pjesë në fazën e kontrollit të prodhimit, i cili vendoset nga vetë trupa ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, nëpërmjet së cilës prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi garanton se instrumenti matës është në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara.

2. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që nuk janë objekt i markimit CE, mund të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm nëse janë verifikuar sipas një procedure të përshkruar në këtë ligj, si rezultat i së cilës është realizuar miratimi i tipit dhe verifikimi fillestar i tij.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe kqyrjes fizike nga afër të instrumentit matës "Taksimetër", Tip M12, konstatuam që instrumenti është në përputhje me ligjin Nr. 126/2020 "Për metrologjinë", Neni 18, pika I, pra instrumenti ka të vendosur markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M dhe dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit të rrethuara nga një drejtkëndësh, lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE si dhe numrin unik të trupës notifikuese dhe si rrjedhojë mund të vendoset në treg referuar këtij neni të ligjit.

Ju faleminderit.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

